

## LIGJI NR. 04/L-226 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

### Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

### Neni 1

Neni 2 i ligjit bazik, pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2, me tekstin si në vijim:

2. Ky ligj nuk zbatohet për marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe për marrëdhëniet që janë objekt i një kontrate kolektive ndërmjet punëdhënësve dhe sindikatave.

### Neni 2

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafi 1.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1. **Marrëveshje** - marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut.

2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.7 riformulohet me tekstin si në vijim:

1.7. **Ndërmarrje** - çdo aktivitet biznesor pavarësisht mënyrës së organizimit ose formës së menaxhimit, ndërmarrësi publike e themeluar për kryerjen e aktiviteteve për interes publik si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik apo autoritet shtetëror që kryen aktivitet ekonomik pavarësisht se a konsiderohet apo jo subjekt afarist.

3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafët 1.9, 1.10 dhe 1.11 fshihen në tërësi.

### Neni 3

Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2 riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Marrëveshjet që ndalohen, sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe që nuk përjashtohen sipas neneve 5, 6, 7, 8 të ligjit bazik dhe nenit 4 të këtij ligji janë të pavlefshme.

### Neni 4

Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet një neni i ri 7A me tekstin si në vijim:

### Neni 7A Përjashtimet Grupore

1. Dispozitat mbi përjashtimet grupore përcaktojnë kushtet të cilat duhet t'i përmbushin disa marrëveshje për të qenë të përjashtuara nga ndalesat e përgjithshme, sipas nenit 4, paragrafit 1 të ligjit bazik.

2. AKK nxjerr akt nënligjor, me të cilat përcakton kushtet për përjashtimet grupore. AKK e njofton Komisionin përkatës parlamentar se paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para se të nxjerr aktin nënligjor me të cilin përcaktohen kushtet për përjashtime grupore.

3. Me dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen në veçanti:

3.1. Kushtet të cilat marrëveshjet duhet t'i përmbajnë;

3.2. Kufizimet ose kushtet që marrëveshjet e tilla nuk guxojnë t'i përmbajnë.

4. Autoriteti mund të iniciojë procedurë për vlerësimin e marrëveshjeve që i plotëson kushtet për përjashtim grupor kur efektet e marrëveshjes, qoftë individuale apo kumulative me marrëveshje të ngjashme në tregun përkatës, nuk i përmbushin kushtet sipas nenit 5, 6 dhe 7 të ligjit bazik.

5. Në qoftë se në procedurën e vlerësimit të ndonjë marrëveshjeje konstatohet se marrëveshja ka efekte që janë në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 5, 6 dhe 7 të ligjit bazik, Autoriteti me vendim do të revokojë përjashtimin grupor për atë marrëveshje.

### Neni 5

Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Autoriteti mund të lejojë një përjashtim të përcaktuar në nenet 5, 6, 7 të ligjit bazik dhe nenit 4 të këtij ligji për marrëveshje të veçantë nëse:

1.1. ka pranuar aplikimin për përjashtimin që përputhet me kërkesat e nenit 9 paragrafit 2. ligjit bazik;

1.2. ka shqyrtuar aplikimin dhe i ka hetuar çështjet e parashtruara në të dhe;

1.3. ka konstatuar se kriteret për lejimin e përjashtimit janë përmbushur.

### Neni 6

1. Neni 10 i ligjit bazik, në paragrafin 2 ndryshohet përqindja e pozitës dominuese nga "**dyzet (40%)**" në "**njëzet e pesë (25%) përqind**".

2. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura mund të jenë në pozitë dominuese nëse në raport me konkurrentet e tyre veprojnë bashkërisht në tregun relevant si dhe nëse pjesëmarrja e përgjithshme e tyre në treg është më e lartë se dyzet (40%) përqind (pozita dominuese kolektive).

3. Neni 10 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4 me tekstin si në vijim:

4. Barra e konstatimit që pozitën dominuese në treg mund ta ketë edhe pjesëmarrësi, pjesa e të cilit në tregun relevant është më e ulët se njëzet e pesë përqind (25%), respektivisht në raste të dominimit kolektiv më e ulët se dyzet përqind (40%), bie mbi autoritetin.

### Neni 7

Në tërë nenin 13 të ligjit bazik fshihet fjala "**të përhershëm**".

### Neni 8

1. Neni 15 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.1, shuma "**njëqind (100) milion Euro**," zëvendësohet me shumën "**njëzet (20) milion Euro**";

2. Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 5, ndryshohet periudha kohore nga **“(20-vjeçare)”** në periudhën kohore **“(2-vjeçare)”**.

#### Neni 9

Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 4, nënparagrafët 4.1 dhe 4.2 fjala **”prodhues”** zëvendësohet me fjalën **”produktit”**.

#### Neni 10

1. Neni 20 i ligjit bazik, paragrafi 3 fshihet fjala **”tregtare”**.

2. Neni 20 i ligjit bazik, paragrafi 8 afati kohor prej **”gjashtëdhjetë (60) ditë”** zëvendësohet me afatin kohor prej **”nëntëdhjetë (90) ditë”**.

#### Neni 11

1. Titulli i Kapitullit 7 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim: **”Autoriteti Kosovar i Konkurrencës”**.

2. Neni 24 i ligjit bazik, paragrafët 1 dhe 2 riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Autoriteti është person juridik me autorizime publike i pavarur në kryerjen e detyrave të veta të përcaktuara në ligjin bazik, si dhe ligjin përkatës për ndihmë shtetërore. Autoriteti për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës;

2. Selia e Autoritetit është në Prishtinë;

3. Neni 24 i ligjit bazik, paragrafi 6 riformulohet me tekstin si në vijim:

6. Tarifat administrative, masat ndëshkuese administrative të cilat i shqipton Autoriteti janë të hyra që derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

#### Neni 12

1. Neni 25 i ligjit bazik, paragrafi 4, riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e Komisionit Kosovar të Konkurrencës propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi.

2. Neni 25 i ligjit bazik, pas paragrafit 4 shtohet një paragraf i ri 5 me tekstin si në vijim:

5. Qeveria, gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të mandatit të anëtarëve të Komisionit, ia propozon Kuvendit për emërim ose riemërim kandidatin për anëtarë të Komisionit.

#### Neni 13

Neni 26 i ligjit bazik, pas paragrafit 3 shtohet një paragraf i ri 4 me tekstin si në vijim:

4. Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë nëpunës civil dhe as të ushtrojnë apo të merren me aktivitet politik.

#### Neni 14

Neni 27 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Kuvendi me shumicë votash mund të shkarkojë kryetarin, zëvendëskryetarin ose një anëtar të Komisionit nëse:

1.1. më propozim të Qeverisë;

1.2. është dënua nga një gjykatë kompetente se ka kryer vepër penale dhe është i dënua mbi gjashtë (6) muaj burgim;

1.3. nuk është në gjendje fizike apo mendore të kryej detyrat për më shumë se tre (3) muaj dhe nuk ka mundësi të ofroj dëshmi mjekësore se do të jetë në gjendje të vazhdoj të kryej detyrat brenda një periudhe shtesë prej tre (3) muajsh;

1.4. në ushtrimin e detyrave të tyre shkelin dispozitat e nenit 26 të ligjit bazik, dhe nenit 13 të këtij ligji;

1.5. Pezullohet nga detyra anëtari i Komisionit nëse kundër tij/saj është ngritur aktakuzë në procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

#### Neni 15

Neni 28 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13 fjala "**harton**" zëvendësohet me fjalën "**aprovon**".

#### Neni 16

Neni 30 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Organizmi, funksionimi dhe strukturimi i administratës së Autoritetit rregullohet me Ligjin në fuqi për shërbimin civil dhe Statutin e Autoritetit.

2. Pagat dhe shtesat për nëpunësit e Autoritetit bazohen në kushtet e veçanta nën të cilat ata i kryejnë detyrat dhe funksionet, për të cilat paguhen në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjisllacionin në fuqi.

#### Neni 17

Neni 33 i ligjit bazik, paragrafi 5, togfjalëshi "**Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës**" zëvendësohet me togfjalëshin "**Gjykata kompetente për çështje administrative**".

#### Neni 18

Neni 35 i ligjit bazik paragrafi 6, togfjalëshi "**Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës**" zëvendësohet me togfjalëshin "**Gjykata kompetente për çështje administrative**".

#### Neni 19

Neni 36 i ligjit bazik paragrafi 2, togfjalëshi "**Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës**" zëvendësohet me togfjalëshin "**Gjykata kompetente për çështje administrative**".

#### Neni 20

Neni 38 i ligjit bazik paragrafi 3., togfjalëshi "**Gjykatës kompetente të Republikës së Kosovës**" zëvendësohet me togfjalëshin "**Gjykata kompetente për çështje administrative**".

#### Neni 21

Neni 44 i ligjit bazik, paragrafi 2 riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Palës duhet t'i sigurohen të gjitha dokumentet e nevojshme nga Autoriteti të përcaktuara me këtë ligj dhe Ligjin për qasje në dokumente publike.

## Neni 22

Neni 46 i ligjit bazik paragrafi 1. fjala “**tregtare**” zëvendësohet me fjalën “**në treg**”.

## Neni 23

1. Neni 53 i ligjit bazik paragrafët 1 deri 6 ndryshohet afati kohor nga “**gjashtëdhjetë (60) ditë**” në “**nëntëdhjetë (90) ditë**”.

2. Neni 53 i ligjit bazik, paragrafi 3 riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Vendimin për ndërprerjen e zbatimit të marrëveshjeve grupore nga neni 4 të këtij ligji, si dhe vendimin për ndryshimin e përqendrimit nga neni 21 paragrafi 3, të ligjit bazik Autoriteti e merr në afat prej katër (4) muajsh nga dita kur konstatohen të gjitha faktet relevante, respektivisht në afatin prej katër (4) muajsh nga dita e përfundimit të seancës kryesore.

## Neni 24

Pas nenit 57 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 57A me tekstin si në vijim:

### Neni 57A

1. Me gjobë në shumë prej një mijë (1000) euro-deri në tremijë (3.000) euro dënohet personi përgjegjës i ndërmarrjes, nëse është i involvuar në shkeljet që parashihen në nenet 56 dhe 57 të ligjit bazik.

2. Me gjobë në shumë prej 1000 euro-deri në tremijë (3.000) euro dënohet personi përgjegjës i organit shtetëror, nëse është i involvuar në shkeljet që parashihen në nenet 56 dhe 57 të ligjit bazik.

## Neni 25

Neni 58 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Masa ndëshkuese, në shumë prej një mijë (1.000) deri në tre mijë (3.000) euro i shqiptohet ndërmarrjes e cila nuk e ka statusin e palës në procedurë, dhe që nuk vepron sipas kërkesës së Autoritetit në pajtim me nenin 38 paragrafi 1. dhe 3 të ligjit bazik.

## Neni 26

Neni 62 i ligjit bazik, paragrafi 4 riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Inicimi i konfliktit administrativ e ndalon ekzekutimin e vendimit.

## Neni 27 Aktet nënligjore

Të gjitha aktet nënligjore, të parapara me këtë ligj, përgatiten dhe miratohen nga institucionet përkatëse, në afat prej gjashtë (6) muajsh, prej ditës kur ky ligj hyn në fuqi.

## Neni 28 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-226**  
**13 shkurt 2014**

**Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës**